



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 3, datë 28.01.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË, QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Ligjit Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike“ i ndryshuar, Udhëzimit nr.3, datë 17.02.2017 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar, Udhëzimit nr.4, datë 17.02.2017 “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike” i ndryshuar, Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike deri në 6%”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe projektbuxhetin afatmesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike si më poshtë vijon:

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
- Familja përpara se të përzgjidhet për t'u trajtuar me këtë fond duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
- Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paafte për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.

2. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fonde të buxhetit vendor të Bashkisë Durrës si më poshtë vijon:

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
- Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paafte për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
- Familjet me kryefamiljare gra, (të veja, të divorcuara ), me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
- Familjet të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, por që kanë probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin, etj), të cilët kanë vështirësi punësimi.
- Familjet rome, të cilat kanë problem me regjistrimin dhe transferimin.
- Familjet me një anëtar, që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
- Familjet me kryefamiljare gra, të cilat kanë të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë dhe ju ka përfunduar urdhëri i mbrojtjes.

3. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përlogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, datë 17.02.2017 "Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike" i ndryshuar.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 31.01.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 90 / prot.



Durrës, më 04.02.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

BASHKICIA DURRE  
04.02.22 258/8

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.3 datë 28.01.2022 "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor..

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

